



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 549/4 Prot.

Pogradec, më 06.12. 2021

VENDIM

Nr. 106, datë 02.12.2021

PËR

**“LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE NË RASTET E SHKELJEVE DHE
KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE NË BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të pikës 1, gërma “a” dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës; të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 9 pika 1 germat a, b; neni 54 pika “k”, në nenin 6 gërma “b”, nenin 10 pika 3 të ligjit nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; në ligjin nr.9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM nr.408, datë 31.05.2015 “Për miratimin e rregullores të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM- së nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike” nenit 4, 8 pika 4, nenit 12, nenit 18 pika 1.2, nenit 29 pika 1, dhe nenit 34, të ligjit nr.9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar; neni 14 ,15 19,35 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar; Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Llojet dhe nivelet e gjobave në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative në Bashkinë Pogradec” sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e penaliteteve, referuar nivelit 8 ,Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Ngarkohet Policia Bashkiake për zbatimin e penaliteteve referuar niveleve të tjera .
4. Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”.
5. Përrjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.
6. Shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme të Këshillit të Bashkisë, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes publike.

KRYETAR

Sotiraq MANGËRI

Lidhja 1

**“Llojet dhe nivelet e gjobave në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative në
Bashkinë Pogradec”**

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo lejë përkatëse.	
a. Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti :	
<ul style="list-style-type: none">• Transport udhëtarësh taksi (1+4)	10,000 lekë
<ul style="list-style-type: none">• Transport udhëtarësh taksi (1+8)	15,000 lekë
<ul style="list-style-type: none">• Transport udhëtarësh me autobus	20,000 lekë
<ul style="list-style-type: none">• Mjete të tonazhit të lartë	20,000 lekë
<ul style="list-style-type: none">• Hyrja pa autorizim në rrugët e qytetit për mjetet e tonazhit të mesëm dhe të lartë.	15,000 lekë
<ul style="list-style-type: none">• Hyrja pa autorizim në rrugët e zonave historike qytetit për mjetet e tonazhit të mesëm dhe të lartë	20,000 lekë
<ul style="list-style-type: none">• Mospajisja me liçensë për agjensi transporti udhëtarësh kombëtare apo ndërkombëtare	20,000 lekë
b. Mospajisje me liçensë për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësisive të shitjes së lëndëve djegëse	20,000 lekë
c. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	1,000 deri 5,000 lekë

d. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike (trotuar, sheshe e.t.j)	20,000 lekë
e. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh" pas orarit të lejuar.	20,000 lekë
f. Mospajisje me lejë për zënie të hapësirës publike <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtarive (ekspozim malli, promocione, panaire, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike. 	10,000 lekë
g. Mospajisje me leje për vendosje reklame : <ul style="list-style-type: none"> • e thjeshtë • elektronike 	20,000 lekë
h. Në rastet e konstatimit të ndotjes akustike mbi nivelet e lejuara në ambientet e brendshme dhe të jashtme të lokaleve.	20 000 lekë
j. Në rastet e konstatimit të muzikës me këngëtare ose me aparatura të dixhitalizuara në individualizim të çdo subjekti që operon me aktivitet tregetar (bar – kafe, bar – restorant e.t.j) përveç rasteve të pajisura me lejë nga Bashkia.	20,000 lekë
2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa lejë të posaçme.	
a. Dëmtim rruge.	10,000 deri 20,000 lekë
b. Çarje rruge.	10,000 deri 20,000 lekë
c. Bllokim rruge, korsi biçikletash dhe hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promocionale, konë parkimi, sende të tjera)	10,000 deri 20,000 lekë
d. Dëmtim bordure (ndryshim pozicioni fillestar, thyerje,	

shpërngulje e.t.j)	10,000 deri 20,000 lekë
e. Dëmtim trotuari (heqje pllakash, vendosje pusete, vendoje tendash, vendosje mjete promociionale e.t.j)	10,000 deri 20,000 lekë
f. Çarje trotuari	10,000 deri 20,000 lekë
g. Bllokim trotuari, korsi biçikletash ,hapësira të tjera publike në të (me inerte,materiale të ngurta, mjete promociionale, vazo lulesh, pedana e.t.j)	5,000 deri 20,000 lekë
h. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	20,000 lekë
i. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit të tonazhit të rëndë dhe të lehtë :	
- Persona juridikë	20,000 lekë
- Persona fizikë	10,000 lekë
- Banorë të qytetit dhe njësive administrative	5,000 lekë
3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e shpërndarjes dhe ndriçimit rrugor pa lejë të posaçme.	
a. Lidhje ose mirëmbajtje e pamiratuara në rrjetin ajror (fibra optike, kablllo shpërndarësë e.t.j)	10,000 deri 20,000 lekë
b. Dëmtim të shtyllave të rrjetit shpërndarës apo ndriçimit rrugor	15,000 deri 20,000 lekë
c. Dëmtim i ndriçuesve	10,000 deri 20,000 lekë
d. Përdorimi i shtyllave të rrjetit shpërndarës apo ndriçimit rrugor si suport për montimin e reklamave, kapjen e kablllove etj.	20,000 lekë

4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza.	
a. Lidhje e pa miratuar në tubacion.	20,000 lekë
b. Dëmtim i tubacioneve nga punimet që kryen pranë tyre me lejë apo pa lejë.	20,000 lekë
5. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta dhe publike.	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	10,000 deri 20,000 lekë
b. Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve, vepra arti, elemente dekorative.	10,000 deri 20,000 lekë
c. Zënie e hapësirës të gjelbër (tavolina, promocione e.t.j)	20,000 lekë
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash, posterash, oftimesh në pemët dekorative.	10,000 lekë
e. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate.	20,000 lekë
h. Hedhje e mbeturinave jashtë pikave të përcaktuara të depozitimit të mbetjeve organike, inetre, e.t.j.	5,000 deri 20,000 lekë
g. Ndezja e zjarreve dhe ndezja e mbeturinave.	10,000 lekë
h. Rezervim i parkingut pa lejë.	5,000 deri 20,000 lekë
j. Shfrytëzim i hapësirave publike për antenat e kompanive celulare.	20,000 lekë

6. Niveli i gjobave për sektorin e kontrollit veterinar.	
a. Për mishin e therur të tregëtuar të pa çertifikuar .	10,000 lekë
b. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Bashkisë Pogradec.	10,000 deri 20,000 lekë për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës
c. Në rast të mosmarrjes së masave për izolimin kafshëve të luksit.	5,000 lekë
d. Në rast të mbajtjes së bletëve, lepujve, shpendëve (pula, pata, pëllumba, e.t.j të ngjashme me to) në ambientet e banesave kolektive apo banesave individuale brenda territorit të Bashkisë Pogradec.	10,000 deri 20,000 lekë
e. Në rast të konstatimit të tregëtimit të kafshëve të prodhimit jashtë tregjeve të miratuara nga Bashkia Pogradec.	5,000 lekë
f. Në rast të konstatimit të therrjeve të kafshëve të prodhimit jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Pogradec.	10,000 deri 20,000 lekë për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës.
7. Niveli i gjobave për veprimet në liqen.	
a . Marrja e rërës nga bregu liqenit.	10,000 deri 20,000 lekë
b . Hedhja e mbeturinave në bregun e liqenit.	10,000 deri 20,000 lekë
c. Larja teshave në bregun e liqenit.	10,000 deri 20,000 lekë
d. Larja e automjeteve në gjithë bregun e liqenit.	10,000 deri 20,000 lekë

e. Hyrja e varkave të pa rregjistruara dhe të pa kolauduara nga organet kompetente.	10,000 deri 20,000 lekë
f. Parkimi i varkave jashtë vendeve të caktuara	10,000 deri 20,000 lekë
8. Niveli i gjobave për inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.	
a. Mos deklarim i personave që kërkojnë akomodim kundrejt pagesës në subjektet me emërtim hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim dhe numri i netëve të qëndruara në hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër.	20,000 lekë